


# FJALA JONË

Të gjithë kanë të drejtën të votojnë



# VENDIM PËR SHTETIN

## BASHKË PËR DEMOKRACINË

ALDIN (11), AMAR (11), AIDA (11), DRILON (11), ETRIT (11), ELHAME (11), JON (11), MELISA (11)



Në këtë vizatim ne kemi paraqitur disa nga elementet kryesore të demokracisë

### Ne jemi klasa VI-6 dhe kemi të drejtë të flasim lirshëm si dhe t'i shprehim mendimet tona

Sot ne u ndamë në tri grupe dhe edukatorja e grupit tonë na tregoi shumë gjëra si dhe na dha shumë njohori rreth mënyrës se si funksion demokracia në vendin tonë. Disa nga temat të cilat i përmendëm ishin: domethënia e fjalës demokraci si dhe vendi dhe viti kur është themeluar demokracia. Fjala demokraci do të thotë qeverisje e popullit. Demokracia si qeverisje shumë e rëndësishme, u themelua në vitin 507 para erës sonë në Athinë, pra në kryeqytetin e Greqisë. Demokracia për ne do të thotë: liri e shprehjes, barazi për të gjithë, jetesë më e mirë etj. Këto të drejta na sigurohen nga ligjet dhe nenet, të cilat siç e dijme miratohen nga deputetët. Ligjet në Kosovë funksionojnë në mënyrë të barabartë dhe pa dallime, pavarësisht gjinisë, racës apo fesë.

Disa nga nenet janë këto:

1. Të gjithë njerëzit kanë të drejtë për pushim dhe argëtim.
2. Çdo njeri i akuzuar për vepër penale konsiderohet i pafajshëm deri sa të vërtetohet fajësia e tij.
3. Të gjithë njerëzit kanë të drejtën e lirisë, jetës dhe mbrojtjes.
4. Çdo njeri ka të drejtën për një punë që i përshtatet jetës së tij.

5. Çdo njeri ka të drejtë të mbrohet me ligj në rast se dikush e fyen apo i shqetëson familjen e tij.



Shteti ynë na jep të drejta të barabarta të gjithëve




Çdo herë bashkëpunim nga ne




Sortimi i mbeturinave



Të drejtat dhe përgjegjësitë



Voto sepse është e drejtë e jotja



Funksion i Kuvendit është miratimi i ligjeve



Një punim i nxënësve të klasës 6/1



Bashkëpunimi i nxënësve

# POPULLI VENDOS PËR TË ARDHMEN E TIJ


MURAT (13). LEONIT (11), ERALED (12), KALTRINA (11), AGNESA (12), ARBERINA (12), ARDI (11),  
ALMIRI (11)

**Pse është e rëndësishme të votojmë? Kur e kemi të drejtën e votës? Këto dhe shumë informata të tjera do t'i mësoni në artikullin më poshtë**

Populli vendos për të ardhmen e vet duke votuar lirshëm dhe duke zgjedhur deputetët apo përfaqësuesit e vendit. Ne bëjmë shumë zgjedhje në jetën e përditshme, p.sh. zgjedhim kryetarin e klasës. Megjithatë për të votuar në procesin zgjedhor në shtetin tonë, kemi të drejtë nga mosha 18 vjeçare, sepse jemi më të pjekur dhe e dimë më mirë se kë duhet ta votojmë. E drejta e votës është përgjegjësi e çdo qytetari, prandaj secili duhet të votojë, sepse në demokraci mendimi i secilit vlen. Vlera e votës është shumë e madhe dhe vetëm një votë mund të bëjë ndryshim. Bëhu ti ndryshimi dhe vendos vet për të ardhmen tënde.




Votuesit e së ardhmes




Ne e kemi të drejtën e votës nga mosha 18 vjeçare



Janë dy lloje të zgjedhjeve: zgjedhjet qendrore dhe lokale




Të gjithë duhet të mendojmë mirë për atë që do ta votojmë



Vota jonë vendos se kush do ta udhëheq vendin

## NE JEMI QYTETARË

DAOR (11), LENDINA (11), ERONI (11), ELMEDINA (11), GENTRITI (12), ALMIRA (11), ENDRI (11), PAJAZITI (11), MILOTI (11)



### Ne kemi të drejta, të cilat duhet t'i dijmë dhe përgjegjësi të cilat duhet t'i kryejmë që të jemi qytetarë më të mirë

Kush janë qytetarët? Çdo individ i cili ka leje qëndrim në një shtet të caktuar është qytetar.

Qytetarë nuk konsiderohen vetëm të rriturit, por edhe ne si fëmijë. Prandaj, edhe ne si qytetarë të Republikës së Kosovës kemi të drejta të cilat na i ofron mënyra e qeverisjes së shtetit tonë, e cila është demokracia.

Disa nga të drejtat tona janë: e drejta e shkollimit, ku të gjithë fëmijët e shtetit tonë vijojnë mësimin e rregullt dhe të obligueshëm deri në klasën e IX-të.

E drejta e të shprehurit lirshëm, ku ne e kemi këtë të drejtë çdo ditë si në shkollë ashtu edhe në familje, madje edhe sot këtu në Punëtorinë e Demokracisë „Demos-ti“.

Kemi edhe të drejta të tjera siç janë: e drejta e lëvizjes së lirë, e drejta e votimit, e drejta e zgjedhjes së profesionit e shumë të drejta të tjera.

Perveç të drejtave, ne kemi edhe përgjegjësitë tona që duhet t'i kryejmë: ta mbajmë ambientin të pastër, së bashku ta pastrojmë shkollën, klasën, lagjen etj. Gjithashtu, kemi mundësi t'i mbledhim mbeturinat e plastikës dhe t'i riciklojmë ato, ndërsa me ato të holla që i kemi mbledhur, mund t'i dhurojmë për bamirësi. Përgjegjësi tjetër është t'i dëgjojmë prindërit dhe t'u


përmbahemi këshillave të tyre, sepse ata mendojnë për të mirën tonë.

Kemi përgjegjësi edhe t'i kryejmë detyrat e shtëpisë, t'i ndimojmë njerëzit në nevojë etj.

Ne nxënësit e klasës së gjashtë të shkollës „Zenel Hajdini“ në Prishtinë, kemi një mesazh për bashkëmoshatarët tanë, që të informohen më shumë për të drejtat e tyre dhe t'i kryejnë përgjegjësitë e tyre në mënyrë që të bëhen qytetarë sa më të mirë, pra qytetarë aktiv.



Gazetatët e rinjë të Kuvendit



## IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI  
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA  
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



**ERSTE Stiftung**

Redaktohet nga  
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit  
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga  
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë:  
Tel: +381 38 704 560  
E-mail: [info@demos-ti.org](mailto:info@demos-ti.org)  
Website: [www.demos-ti.org](http://www.demos-ti.org)

Pjesëmarrësit:  
SHFMU „Zenel Hajdini“  
Klasa: VI-6  
Vendi: Prishtinë